

UNIVERSITETI I PEJES HAXHI ZEKA
FAKULTETI MENAXHIM NË TURIZËM HOTELERI DHE MJEDIS
DEPARTAMENTI MENAXHIM NË TURIZËM



PUNIM DIPLOME

Autori:

HYRIJE BAJRAMAJ

Tema:

**ZHVILLIMI I TURIZMIT FAKTOR I RËNDËSISHEM NE RRITJEN
EKONOMIKE NË KOSOVË**

Mentori:

Porf.Ass.Dr. Bekë KUQI

Kandidatja:

Hyrije BAJRAMAJ

Pejë, 2024

UNIVERSITETI I PEJËS HAXHI ZEKA
FAKULTETI MENAXHIM NË TURIZËM HOTELERI DHE MJEDIS
DEPARTAMENTI MENAXHIM NË TURIZËM



PUNIM DIPLOME

Lënda: BURIMET E TURIZMIT NATYROR

Titulli i Punimit: ZHVILLIMI I TURIZMIT FAKTOR I RËNDËSISHËM NE RRITJEN EKONOMIKE NË KOSOVË

Emri dhe Mbiemri:	HYRIJE BAJRAMAJ
Statusi i Studentit:	e rregulltë
Numri I Amëz (ID Regjistri):	310602021
Niveli i Studimeve:	Bachelor
Departamenti:	Menaxhim në turizëm, hoteleri dhe mjedis
Programi i Studimit:	Menaxhim në turizëm
Mentori i Punimit:	Prof.Acc.Dr. Bekë KUQI

Aprovimi prej Komisionit:

- 1. Mentori**
Emri/ Mbiemri /Titulli: Prof.Ass. Dr. Bekë KUQI
- 2. Anëtar**
Emri /Mbiemri/ Titulli: Prof. Asoc. Dr. Alberta TAHIRI
- 3. Anëtar**
Emri/ Mbiemri/ Titulli: Prof. Asoc. Dr. Afrim SELIMAJ

LISTA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA	7
FALENDERIMET.....	8
DETIKIMI.....	9
QELLIMI I HULUMTIMIT	10
METODAT DHE METODOLOGJIA E KËRKIMIT	10
ABSTRAKT.....	11
HYRJE.....	12
KAPITULLI I.....	13
I.1.Ç'ËSHTE TURIZMI, TURISTI	13
I.2.TURIZMI NË KOSOVË	13
I.3. LLOJET E TURIZMIT NË KOSOVË.....	14
I.3.1. Turizmi kulturor:	14
I.3.2. Ekoturizmi	14
I.3.3 Turizmi rural	15
I.3.4. Turizmi kongresial.....	15
I.3.5. Turizmi shendetsor	15
I.4. EKONOMIA TURISTIKE E KOSOVËS NË PËRIUDHËN 1960-1989	16
KAPITULLI II	18
II.1. FAKTORËT E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT.....	18
II.1.1. Faktorët natyrorë	18
II.1.2. Faktorët kulturorë historikë	18
II.1.3. Faktorët ekonomik.....	18
II.1.4. Faktorët shoqërorë	18
II.1.5.Faktorët politikë dhe ligjorë	19
II.2. POTENCIALET TURISTIKE.....	19
II.3. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	20
II.4.RENDËSIA E PUNËSIMIT NË TURIZËM	21
II.5. RENDËSIA E KOHËS SE LIRE PËR TURIZMIN.....	21
II.6.TURIZMI DHE MJETET E LIRA	22
KAPITULLI III	23
III.1.RESURSET TURISTIKE	23
III.2. RAJONET TURISTIKE.....	23
III.3. RESURSET TURISTIKE NATYRORE	24
III.4. DESTINACIONET TURISTIKE NË KOSOVË	27
III.4.1. Shpella e Kusarit	27

III.4.2. Drini i Bardhë.....	27
III.4.3. Kalaja e Prizrenit.....	28
III.4.4. Liqenet e Mirushës.....	28
III.4.5. Ulpiana	28
III.4.6. Shpella e Gadimes	28
III.4.7. Gryka e Rugovës	28
III.4.8. Pylli i arinjve Prishtina	29
III.4.9. Kalaja e Artanës.....	29
III.4.10. Liqenati	29
KAPITULLI IV.....	30
IV.1. MUNDËSITË E INVESTIMIT NË KOSOVË	30
IV.1.1 Rendësia e Energjisë dhe minierave në Kosovë	30
IV.1.2 Kapaciteti energjetik në Kosovë.....	30
IV.1.3 Bujqësia dhe blegtoria ndikimi i tyre në ekonomi.....	31
IV.1.4 Përpunimi i drurit dhe zhvillimi i eksportit.....	31
IV.1.5 Niveli dhe rendësia e ndërtimtarisë në Kosovë	31
IV.1.6 Turizmi dhe rendësia direkte në ekonomi	32
IV.2. NDIKIMI I COVID-19 NË INVESTIME.....	33
IV.3. OBJEKTET HOTELIERE DHE RRITJA EKONOMIKE.....	33
IV.4. KAPACITETI I KOSOVËS PËR TURIZËM	34
IV.5. INFRASTRUKTURA NË KOSOVË.....	35
IV.5.1. Infrastruktura Rrugore	35
IV.5.2. Infrastruktura Hekurudhore	35
IV.5.3. Infrastruktura Ajrore.....	35
KAPITULLI V	36
V.1. RËNDËSIA E PROMOCIONIT.....	36
V.2. RËNDËSIA E MARKETINGUT	36
V.3 RËNDËSIA E AKTIVITETEVE TURISTIKE NË EKONOMI	37
KAPITULLI VI.....	39
VI.1 REZULTATET NGA PYTSORI	39
REKOMANDIME.....	43
PËRFUNDIM.....	44
BURIME NGA INTERNETI	45
LITERATURA	46

LISTA E TABELAVE

TABELA 1. DISA NGA LLOJET E TURIZMIT	14
TABELA 2. NUMRI I PUNËTORËVE NË HOTELERI NË KOSOVË 1984-1988.....	16
TABELA 3.NUMRI I VIZITORËVË NË KOSOVË 1960-1988.....	17
TABELA 4. RAJONET TURIATIKE.	23
TABELA 5. MAJAT KRYESORE NË KOSOVË.	24
TABELA 6.LUMENJET KRYESOR TË KOSOVËS.....	24
TABELA 7. LIQENET NATYRORE TË KOSOVËS.....	25
TABELA 8. LIQENET ARTIFICIALE TË KOSOVËS.....	25
TABELA 9. GRYKAT DHE KANJONET E KOSOVËS	26
TABELA 10. DISA NGA SHPELLAT E KOSOVËS.....	26
TABELA 11. BURIMET TERMO-MINERALE TË KOSOVËS	26
TABELA 12. KAPACITETET HOTELIERE NË KOSOVË 2020-2023.....	34
TABELA 13. LLOJET E INFRASTRUKTURES	35
TABELA 14. : NUMRI I VIZITORËVE TË JASHTËM DHE NETËQENDRIMET 2019-1023	37
TABELA 15. NUMRI I VIZITORËVE NË KOSOVË	38

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1. RAJONI MË I PREFERUAR.....	39
FIGURA 2. NË ÇFARË FORME REALIZOHEN ME SHUMË UDHËTIMËT.....	40
FIGURA 3. LLOJI ME I PËRDORUR I UDHËTIMEVE.....	41

DEKLARATA

Unë Hyrije Bajramaj deklaroj së ky punim me titullin, Zhvillimi i Turizmit faktor i rëndësishem ne rritjen ekonomike në Kosovë, është marrë seriozisht, me një përgjegjësi të madhe, është punimi im original, i realizuar pa ndihmesë të ndaluar.

I gjithë punimi është marrë nga literatura të ndryshme, burimet e tjera që kam shfrytëzuar për hartimin e këtij punimi janë të listuara në referenca si dhe janë plotësisht të cituara.

FALENDERIMET

Se pari e Falenderoj Allahun që me mundësoj ti përfundoj me sukses tri vite të studimeve.

Po ashtu kam nderin dhe kenaqësin të falenderoj të gjithë profesorët dhe të gjithë stafin akademik UNHZ, për shpërndarjen e dijës së tyre duke me ngritur mua si në menyrën intelektuale poashtu dhe në atë profesionale.

Falenderim i veçant i shkon mentorit Prof. Ass. Dr. Bekë Kuqi, për përkrahjen dhe kontributin edhe në këtë temë Diplome.

Gjithashtu një tjetër Falenderim i veçant dhe i sinqert shkon për Familjen time, për përkushtimin, dashurinë, mbështetjen morale dhe financiare që më kanë ofruar.

Familja është gjithmonë një burim i madhë i dashurisë, forcës, motivimit, dhe inspirimit, për këtë arsye dua të them se mbështetja e tyre ka pasur ndikim të madh në jetën time dhe shkollimin tim, dhe se jam shumë e lumtur për përkushtimin e tyre në çdo moment. Mbështetja dhe besimi i tyre ka qënë bekimi im me i madh.

Për fund dua ti falenderoj të gjithë ata që më mbështeten jo vetëm tani por gjatë tri viteve të studimeve, duke përfshirë Koleget dhe gjithë Profesoret, Faleminedrit për keshillat dhe ndihmën që më keni ofruar gjatë rrugëtimit tim.

DETIKIMI

Gjithë suksesin dhe arritjet e mija i'a detikoj Nënës.

Nënës sime e cila asnjeher nuk dyshoj tek unë dhe aftësitë e mija.

QELLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit të temës: Zhvillimi i turizmit si faktor i rëndësishëm në rritjen ekonomike në Kosovë, është të analizojë dhe të vlerësojë rolin dhe ndikimin e turizmit në ekonominë e Kosovës. Pra ka për qëllim të evidentojë dhe të japë rëndësinë që i përkët sektorit të turizmit i cili ndikon direkt në rritjen ekonomike dhe shtimin e të ardhurave.

Përmes këtij punimi, synohet të ofrohet një pasqyrë e qartë dhe e detajuar e rolit të turizmit në ekonominë e Kosovës, të identifikojë mundësitë dhe sfidat dhe të sugjerohen masa konkrete për të maksimizuar përfitimet ekonomike dhe sociale nga ky sektor.

Një nga qëllimet është dhe hulumtimi rreth dëshirave dhe kërkesave të turistëve gjë e cila me se miri mund të kuptohet nga pyetësi apo anketa, të cilën e përgatita po për të njëjtin qëllim, pra për të parë se ku qëndrojnë njerzit me preferencat e tyre.

METODAT DHE METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Të dhënat për këtë studim u mbledhën nëpërmjet burimeve të cilat janë mbledhur përmes kërkimeve në internet dhe përmes librave të ndryshëm. Mund të themi se kam përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit duke përfshirë: metoden sasiore, metoden cilesore të quajtur edhe kualitative përmes së cilës sigurojmë kuptimin dhe sqarimin e rasteve studimore, metoden krahasuese, metoden konfirmative, e cila rrjedh prej hipotezave të cilat bazohen në teori apo në rezultate të studimeve të mëparshme, metoden eksploruese, mbledhjen e të dhënave në mënyrë sekondare dhe në mënyrë primare duke përfshirë rezultatet e pyetësorit apo të anketes.

ABSTRAKT

Në këtë punim do të flasim për Turizmin, rëndësinë e tij në vend, llojet e turizmit, atraksionet natyrore, historike, kulturore, rritjen e investimeve dhe kontributin në zhvillimin e infrastrukturës, ndikimin e tyre në turizem.

Gjithashtu do të flasim për potencialet dhe rajonet turistike më të frekuentuara, me të preferuara dhe më flukse turistike,

Menaxhimi i turizmit është një faktorë kyç në rritjen ekonomike të Kosovës. Duke pasur parasysh potencialin natyror dhe kulturor të vendit, zhvillimi i sektorit të turizmit mund të sjellë rritje të rëndësishme ekonomike, duke krijuar vende pune, duke rritur investimet dhe duke kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës.

Një strategji e mirëmenaxhuar e turizmit mund të ndikojë pozitivisht në të ardhurat nga eksportet, duke sjellë një balance më të mirë të llogarisë së jashtme dhe duke ndihmuar në diversifikimin e ekonomisë së vendit.

Zhvillimi i turizmit forcon ekonomikisht vendin dhe Kosova ka shance të mrekullueshme për zhvillimin e turizmit edhe pse nuk posedon Deti, ajo ka mjaftë resurse dhe atraksione turistike që pa dyshim që e bëjnë Kosovën vend jashtëzakonisht të veçantë.

HYRJE

Kosova është një vend i vogël në Ballkanin Perendimor, me një histori të pasur dhe kulturë të përzier. Pas luftës së Kosovës në vitet 1989-1999 dhe ndërhyrjes së NATO-s, Kosova u bë e pavarur në vitin 2008. Kryeqyteti i saj është Prishtina. Popullsia e Kosovës përbehet kryesisht nga shqiptarët, por ka edhe minoritete të tjera si serbë, boshnjak, turq. Kosova është e njohur për bukuritë natyrore të saj, duke përfshirë malet, lumenjet dhe fushat e gjera. Gjithashtu është vlerësuar për trashëgiminë kulturore të pasur, e cila përfshinë monumente të lashta, tradita të hershme, muzikë dhe gastronomi të veçanta. Po ashtu ka dhe një pasuri historike dhe të shumanshme që shtrihet nëpër shekuj siç janë: Kalat, Manastiret, Kishat, Site arkeologjike. Kosova me poziten e saj gjeografike ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit në vend. Pozicioni gjeografik i saj e bënë destinacion të veçantë dhe tërheqës për të gjithë vizitorët të cilët janë në kerkim të aventurave të reja, me gjithë resurset apo atraksionët turistike që jo çdo vend ka fatin të posedoj. Kosova posedon shumë resurse të çmuara dhe të mahnitshme që i'a vlen për tu eksploruar dhe të shfrytëzohen për të promovuar zhvillimin e vendit në shumë. Gjithashtu përmes shfrytëzimit të resurseve në menyrë të qëndrueshme dhe të menaxhuara mirë, Kosova ka potencialin për të krijuar një industri të fortë turistike, të promovojë cilësinë e jetës për banorët e saj. Kosova është territor më vlera të larta gjeomorfologjike. Të gjitha paraqesin vlera të rëndësishme në kompletimin e ofertës turistike. Relievi me forma atraktive, paraqet potencialistik, i cili përfshin me interes të veçantë për tu vizituar. Në reliev gjenden të gjitha format, duke filluar nga malet e larta, si motive turistike, të cilat prijnë me peisazhin e bukur me gryka të thella si gryka e Rugovës, Bistrica e Deqanit, Shpella e Gadimës dhe e Radavcit¹ (REÇICA und MILLAKU, Hyrje në Turizëm 2014, 270). Me mikpritjen dhe ngrohtesin të cilën i karakterizon popullin Kosovar. Me trashëgimit kulturore, veshjet kombëtare, folklorin, zakonet, traditën në gastronomi ju ipet perparsi e madhe që ti kurorëzojë edhe me mirë të gjitha resurset tjera që i posedon. Është ai imazh që i fiksohet në kokë në një grup turistësh. Falë kulturës së tyre duke u dhënë mundësi të shijojnë të gjithë pasurin kulturore (imazhi që krijohet për vende të caktuara për trashëgimin kulturore të tij). Ky imazh mbetet në mendjen e turistëve².

¹. Reçica, Fetah; Millaku, Bedri "Hyrje në Turizëm" Fq. 270. Prishtinë, 2014

² https://pjeterbudi-edu.com/wp-content/uploads/2018/05/Revista_Studentore_nr_1_2009-1.pdf, Prill 2009, fq.5.

KAPITULLI I

I.1.Ç'ËSHTE TURIZMI, TURISTI

Emri turist dhe turizëm ka filluar të perdoret më Botë në shekullin XVIII, në vendin turizmit potencial në Britaninë e Madhe. Turistë quhen ata persona, të cilët udhëtojnë në vende të huaja, për shkak të kërshëris dhe të argëtimit, të cilët bëjnë një lloj turneje në ato vende, të cilat zakonisht më parë i kanë vizituar kompatriotët e tyre. Sipas kësaj, nënkuptohet se turist është quajtur atëherë kur dikush ka udhëtuar jashtë vendit të tij ³ (REÇICA und MILLAKU, HYRJE NË TURIZËM 2014)

I.2.TURIZMI NË KOSOVË

Turizmi në Kosovë është një sektor me potencial të madh për zhvillim dhe rritje. Është industria e shërbimeve që përfshin të gjitha aktivitetet, shërbimet dhe infrastrukturën që janë të lidhura me pritjen dhe përkujdesjen e vizitorëve. Përfshin udhëtimin, akomodimin, ushqimin dhe aktivitetet e tjera që ofrohen për vizitorët brenda territorit të Kosovës dhe për vizitorët ndërkombëtar. Ky sektor është i pasur me potencial, duke ofruar një gamë të gjerë të atraksioneve natyrore të bukura, trashëgimi kulturore dhe historike të pasur, kuzhin autentike. Gjithashtu përfshinë aktivitete dhe anëtarë që synojnë të promovojnë dhe të zhvillojnë sektorin e turizmit në mënyrë të qëndrueshme dhe inovative. Kjo përfshinë hulumtimin dhe zhvillimin e produkteve turistike të reja, përdorimin e teknologjise për të përmirësuar përvojën e udhëtarëve, përgatitjen dhe trajnimin e personelit turistik, si dhe bashkëpunimin me komunitetet lokale për të siguruar një përvojë autentike dhe të përshtatshme për udhëtarët. Turizmi në Kosovë është një fushë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, dhe është në fokus të investimeve dhe përpjekjeve për të arritur potencialin e plotë të industrisë së turizmit. Duke e parë rëndësinë e turizmit për ekonominë dhe ndikimin e tij direkt në produktin shoqëror dhe të ardhurat nacionale; ndikimi i turizmit në zhvillimin e veprimtarive ekonomike që e përbejnë ekonominë turistike (komunikacioni, tregtia, hoteleria, veprimtaritë komunale, institucionale, kulturore, etj.): ndikimi, rritja e punësimit dhe standardit jetësor; ndikimi pozitiv në bilancin pagesave; ndikimin e zhvillimit të vendeve dhe rajoneve të pazhvilluara; mundësinë e investimeve të huaja; rëndësia e turizmit në planin e forcimit të prestigjit (imazhit) të Kosovës në lemin ndërkombëtar, me qëllim të realizimit të detyrave të parapara⁴.

³ Reçica, Fetah; Millaku Bedri "Hyrje në Turizëm" Fq. 12, 13, 14. Prishtinë, 2014.

⁴ Reçica, Fetah; Millaku, Bedri "Hyrje në Turizëm" Fq.265. Prishtinë, 2014.

I.3. LLOJET E TURIZMIT NË KOSOVË

TABELA 1. Disa nga llojet e turizmit

Llojet e turizmit	Veçoritë e destinimit dhe motivit të pushimit
1.Turizmi kulturor	Zakonët dhe traditat e vendit.
2.Turizmi historik	Muzetë, katedralet, llojshmëria historike e traditave të ndryshme.
3.Turizmi reaktiv	Turizmi masovik veror: diell, rërë, det, relakism pushim në borë, sporte gjatë pushimit.
4.Turizmi ekologjik	Hapësirat e natyrës së „Pastër“.
5.Turizmi etnik	Zakonet ekzotike të popujve dhe fiseve.

Në baze të vendeve të zonave turistike, turizmi sot ka marr permasa të zhvillimit. Ne botë po ashtu edhe në Kosovë janë të zhvilluara edhe këto forma apo lloje të turizmit; turizmi bregdetar, turizmi kulturor, ekoturizmi, turizmi rural, turizmi nautik, turizmi kongresial, turizmi i guetise dhe peshkimit, turizmi rinor, turizmi shendetësor, turizmi fetar, turizmi dimeror, etj⁵

I.3.1. Turizmi kulturor:

Qarkullimet turistike në botë dhe tek ne nuk bëhen vetëm për qëllime rekreative, por në vete kane përmbajtjen kulturore, të cilat njohin vizitorin me kulturën e vendit dhe motivet etnosociale. Në Kosovë janë të pranishme Verat e kohërave më të hershme, si ato të kohës antikem, nga të cilat kanë mbetur disa lokalitete arkeologjike, ku janë ruajtur materiale nga qeramika, vegla dhe mjete nga koha Ilirio-Romake. Janë të njohura Ulpiana, Municipiumi i Soçanicës, Kompleksi i Pejës së Vjetër, Vicianumi i Vushtrisë si dhe fortifikatat e vjetra të shkatërruara në shumë vendbanime të Kosovës. Janë të njohura edhe objektet nga Mesjeta, sic janë disa manastire, monumentet e kultures turko-Islame, si më të njohura janë: Xhamia e Sinan Pashës në Prizren, Xhamia e Sulltan Mehmetit II Al Fati, Xhamia e Hadumit në Gjakovë etj. Po ashtu janë të pranishme shumë tyrbe, teqe dhe hamame. Objektet tjera janë: Ura e Terzive afër Gjakovës, Çarshitë e vjetra nëpër qytete (Gjakova, Prizreni, Peja), Sahat kullat, shtëpitë dhe kullat nëpër vendbanimet fshatare e sidomos në Dukagjin. Në Kosovë janë të pranishme një laramani Kulturash, të cilat më së miri deshmohen më veshjet e tyre, më folklorin, lojërat tradicionale. Të gjitha janë vlera me rëndësi për zhvillimin e turizmit⁶

I.3.2. Ekoturizmi

Ekoturizmi është mënyra e udhëtimit modern për të udhëtuar dhe me mendje turistët me qëllim për të mbështetur ruajtjen e mjedisit natyror dhe të trashëgimisë kulturore, gjithëherë në bashkëpunim me komunitetin lokal⁷.

⁵ Selimaj, Afrim; Millaku, Bedri; Dreshaj, Adem “Ekonomia e turizmit dhe biznesi” Fq.46. Viti.2020.

⁶ Reçica, Fetah; Millaku Bedri “Hyrje në Turizëm” Fq. 273, 274. Prishtinë.

⁷ Millaku, Bedri; Reçica, Fetah “Ekonomia e Turizmit” Fq.58, Prishtinë,2011.

I.3.3 Turizmi rural

Turizmi rural (agroturizmi), i cili ka në bazë motivet që i shtyjnë njerëzit për të përjetuar atmosferën e fshatit me natyrën e bukur e të qetë dhe me prodhimet e ndryshme bujqësore e blegtorale natyrore. Ai përbën edhe drejtimin kryesor në kuadër të turizmit familjar⁸. Turizmi rural (Fshatar) është një prej formave dhe faktor i rëndësishëm në aktivizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, e cila ndihmon në ruajtjen e lokale në traditën e identitetit, zakoneve, mjedisit, si dhe forcimin tradicionale, ekologjike të prodhimit vendas i cili ndihmon zhvillimin e zonave rurale në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm. Turizmi rural, në kuptim është qëndrimi i turistëve në një ekonomi shtëpiake (amvisëri), e cila është e organizuar si ekonomi turistike rurale për pushim dhe rekreacion. Shërbimet turistike në turizmin rural janë: mbledhja e frutave, vjelja e pemëve dhe e perimeve, mbledhja e të lashtave, dhënia me qira e kuajve për kalërim dhe shërbimet e tjera në ekonominë shtëpiake në fshat. Në ekonominë shtëpiake në fshat, mund të përgatiten dhe të shërbehen ushqime të ngrohta dhe të ftohta, pije dhe lëngje, kryesisht nga prodhimet e veta. Po ashtu mund të kryhen edhe shërbimet e shijimit të verës dhe të rakisë, të specialiteteve të mishit të prodhimeve të veta, në pjesën e rregulluar të objektit të banimit ose të objektit afarist të formës së mbyllur, me tendë ose të hapur, për persona (ekskursionistë) njëkohësisht.

I.3.4. Turizmi kongresial

Turizmi kongresial konsiderohet një tersi shërbimesh turistike lidhur me organizimin e tubimeve shkencore, politike, profesionale, kulturore sportive dhe të takimeve të tjera, pranimi dhe vendosja e pjesëmarrësve, organizimi i manifestimeve kulturore-zbavitëse dhe i manifestimeve të tjera lidhur me organizimin e kohës së lirë të pjesëmarrësve, si dhe organizimi i veprimtarive përcjellëse (ekspozitat, prezantimet e produkteve dhe shërbimeve, shitja e produkteve, etj.).⁹

I.3.5. Turizmi shëndetsor

Ujërat termale, Kosova ka burime të rëndësishme të ujërave termale, të cilat shfrytëzohen për qëllime mjekësore dhe rekreative. Këto resurse nuk shfrytëzohen racionalisht e as nuk janë hulumtuar sa duhet. Zyrtarisht ekzistojnë vetëm tri qendra shëruese: Banja e Pejës, e Klllokotit dhe Banjëska (në veri të Mitrovicës). Megjithatë, ekzistojnë edhe burime tjera, të cilat nuk shfrytëzohen dhe nuk janë hulumtuar, më të njohura janë: burimi i ujit në Malishevë, Uglar, Poklek, Dobërçan, Lluzhan, Deçan etj.¹⁰

⁸ Doka, Dhimitër; Draçi, Bilal “ Gjeografia e turizmit “ fq.77. Tiranë, 2009

⁹ Selimaj, Afrim; Millaku, Bedri; Dreshaj, Adem “Ekonomia e turizmit dhe Biznesi“ Pejë, 2019.

¹⁰ Revista Studentore “PJETER BUDI “, 2009, fq.37.

I.4. EKONOMIA TURISTIKE E KOSOVËS NË PËRIUDHËN 1960-1989

Fillimi i viteve 1960 në Ish Jugosllavi ekonomia turistike ishte e orientuar në atë mënyrë që të grumbulloj valutën e fortë dhe të nevojshme. Me pak ka qenë i rëndësishëm realizimi i fitimit ekonomik. Ekonomia turistike ishte mbështetur në smimin e ulët dhe numrin e madhë të mysafireve. Kosova u paraqit me vonë në tregun turistik të ish Jugosllavisë për shkak të pozitës koloniale që ka pasur brenda Serbisë dhe izolimit të plotë të komunikacionit.

Pas ndërtimit të magjistrales së Adriatikut dhe të Ibrit në vitin 1971, fillon afirmimi i Kosovës si treg potencial turistik. Në periudhën deri në vitin 1970 Kosova në aspektin turistik ka qenë mjaft e pazhvilluar. Konceptim themelor atëherë ka qenë zhvillimi i turizmit lokal.

Turizmi i Kosovës kishte ngecur shumë pas dinamikës së zhvillimit turizmit të Ish Jugosllavisë dhe Serbisë. Në këtë vlerësim duhet të kemi parasysh se koncepti themelor në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë ishte zhvillimi i sektorit primar dhe sekondar të ekonomisë që do të siguronte zhvillimin e kapaciteteve përpunuese industriale në Jugosllavi dhe Serbi. Vetëm pas vitit 1970 Kosova fillon hulumtimin e mundësive ekonomike për zhvillimin e turizmit¹¹.

TABELA 2. Numri i punëtorëve në hoteleri në Kosovë 1984-1988.

Vitet	1984	1985	1986	1987	1988
Gjithsej	3310	4342	3878	3882	4104
Hotele	1364	2012	1641	1862	2000
Motele	275	219	242	277	314
Bujtina	3	51	93	63	65
Vendbanime turistike	x	x	x	x	x
Kam- teren	30	60	42	39	39
Kafene	708	397	425	465	521
Bufe	587	1561	1145	884	839
Embëltore	x	x	x	x	21
Në Drejtori	343	43	290	292	305

Në tabelë është paraqitur gjendja e të punësuarve në veprimtarinë hoteliere nga viti 1984-1988. Sipas të dhënave shihet se numri i të punësuarve ka pasur rritje pastaj ulje tek viti 1986, 1987, ndërsa prap ngritje tek viti 1988.

¹¹ Reçica Fetah, Millaku Bedri " Ekonomia e Turizmit" fq.296. Prishtinë, 2011.

TABELA 3 Numri i vizitorëve në Kosovë 1960-1988

Vitet	Numri i vizitorëve	Indeksi	%
1960	27524	100	1.32
1970	73745	267.9	3.55
1980	131993	479.5	6.37
1985	161513	586.8	7.79
1987	157197	571.1	7.58
1988	138190	502.07	6.66
Gjithsej	690162	2506.37	33,27

Burim: Vjetari statistikor i KSAK-ESK

KAPITULLI II

II.1. FAKTORËT E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Zhvillimi i turizmit ndikohet nga disa faktor, të cilët mund të klasifikohen në disa kategori të ndryshme:

- 1.Faktorët natyrorë
- 2.Faktorët kulturorë dhe historikë
- 3.Faktorët ekonomikë
- 4.Faktorët Shoqërorë
- 5.Faktorët politikë dhe ligjorë

II.1.1. FAKTORËT NATYRORË

Faktorët më të rëndësishëm natyror që mundësojnë zhvillimin e turizmit në Kosovë mund të përmenden:

- ☐ Pozita gjeografike i mundëson qasje të favorshme në tregun turistik rajonal dhe më gjerë;
- ☐ Kushtet klimatike të favorshme;
- ☐ Relievi i thyer kodrinor dhe malor, i pasur me shumëllojshmëri të florës dhe faunës, natyra dhe ekologjia i krijojnë kushte për zhvillimin e turizmit të gjelbër;
- ☐ Atraksionet turistike si shpellat, grykat, kantonet, lumenjtë, liqenet etj¹².

II.1.2. FAKTORËT KULTURORË HISTORIKË

- Trashëgimia kulturore- ky hynë apo bejnë pjesë të gjitha monumentet, muzetë të cilët i benë të veçantë gjesendet të cilat ruhen aty, po ashtu dhe vendet historike të cilat tërheqin dhe bejnë kureshtar shumë turistë.
- Festat dhe ngjarjet- Festat tradicionale, koncertet të ndryshme, lojra apo ngjarje sportive të cilat tërheqin një numër të madh vizitorësh.

II.1.3. FAKTORËT EKONOMIKË

- Investimet- të cilat mund të behen në infrastrukturë, si airoportet, rrugët dhe hotelet janë të domosdoshme për zhvillimin e turizmit.
- Kostot dhe standartet e jetesës- Gjithëher duhet të kemi parasysh standartin e te ardhurave të vendit dhe faktin që turistët apo vizitorët preferojnë vendin më kosoto të ulët të jetesës dhe standart të lartë të shërbimeve.

II.1.4. FAKTORËT SHOQËRORË

- Mikpritja dhe kultura lokale- Mikpritja dhe shërbimi cilësorë është një përvojë e jashtëzakonshme për turistët.
- Gjuhët e folura- njohja e gjuhëve të ndryshme ndërkombetare e benë me të lehtë komunikimin si dhe i benë të ndihën të mirëseardhur.

¹² https://pjeterbudi-edu.com/wp-content/uploads/2018/05/Revista_Studentore_nr_1_2009-1.pdf, 2009, fq.34

II.1.5.FAKTORËT POLITIKË DHE LIGJORË

- Politikat qeveritare- mbështetja e qytetareve përmes subvensioneve dhe promovimit gjë që është e rëndësishme.
- Siguria dhe stabiliteti politik- të gjithë turistët preferojnë destinacione të sigurta.

II.2. POTENCIALET TURISTIKE

Potencialet turistike janë kushte themelore për zhvillimin e turizmit. Si pjesë fillestare vet definimi i faktorëve të ndryshëm paraqesin kushte për zhvillimin e kësaj veprimtarie ekonomike. Faktorët e ndryshëm zhvillojnë ndikim në krijimin e kërkesave turistike në zona dhe vende të ndryshme turistike. Faktorët për zhvillimin e turizmit janë të karakterit objektiv dhe si të tillë mund të kualifikohen si procese të caktuara turistike që krijohen në hapësirë dhe kohë. Këta kanë attribute të vlerave racionale dhe për këtë arsye quhen faktor racional. Në turizëm faktorët e shumtë janë edhe me origjinë nga vet subjekti, është fjala për ata faktor të cilët kanë të bëjnë me elementet psikologjike dhe shoqërore të shtresave dhe grupeve të ndryshme shoqërore të cilët janë pjesëmarrës në procesin e turizmit.

Turizmi është dukuri e kohës e cila ka të bëjë me faktorët irracional të cilët në të shumtën e rasteve u paraprijnë proceseve të cilat kanë të bëjnë me turizmin, sipas të cilëve faktori njeri, vet subjekti është në qendër të vëmendjes. Në bazë të ndikimit të tyre në turizëm faktoret e turizmit ndahen në dy grupe me të rëndësishme:

1. Në grupin e parë bëjnë pjesë faktoret të cilët kanë të bëjnë me krijimin kërkesës turistike, në të cilën përfshihet pjesa e kërkesës me mënyr komplekse. Rrethanat shoqërore në hapësira të ndryshme, rrethanat ekonomike dhe shoqërore në hapësirat e zhvilluara të botës, shkallën e urbanizmit në ato vende, duke mos përjashtuar edhe disa nga elementet siç janë koha e lirë dhe mjetet e lira të gjitha në dobi të lëvizjeve dhe të qarkullimeve turistike.
2. Në grupin tjetër përfshihen faktoret të cilët ndikojnë në krijimin ofertës turistike, duke përfshirë elementet komplekse si pjesë e kësaj të fundit.

Në këtë grup përfshihen vlerat dhe atraksionet natyrore, motivet kulturore dhe vlerat e trashëgimisë kulturore, objektet përcjellëse si pjesë e ofertës turistike të cilat përbejnë ofertën sekondare duke përfshirë faktorët e ndërtimit të kapaciteteve turistike, mënyrat e organizmit turistike duke e përfshirë edhe komunikacionin në pjesëmarrjen e tij, faktoret subjektiv dhe irracional, të cilët ushtrojnë ndikim në konsumin turistik, në veçanti në ne vetit psiko-sociale të faktorit njeri, në veçanti në grupet njerëzore të cilët janë faktorët baze të cilët shtyjnë qarkullimet turistike. Në zhvillimin e turizmit për t'i dhënë shtytje të madhe është shkalla e urbanizmit në botë. Në këtë zonë lindin kërkesat turistike, lind nevoja për qarkullime turistike. Në këtë zonë janë më të ndotura dhe më të ngulfatura. Popullsia e këtyre zonave ka domosdoshmëri lëvizjen drejt zonave të pastërta natyrore. Vetë mënyrat e jetesës së popullsisë në këto zonë kanë paraqitur nevojën që pjesa e punëtorëve nga punët e lodhshme dhe nga monotonia e përditshme, që të ndajnë një pjesë të ardhurave dhe kohës për rekreacion dhe udhëtime turistike. Zhvillimi i zonave urbane dhe gyteteve të botes me zhvillimin ekonomik

përkatësisht të industrise ka paraqitur nevojën për udhëtime turistike. Vendet e zhvilluara industriale kanë pjesëmarrje më të madhe të popullsisë urbane¹³

Kosova ka shanse të mrekullueshme për zhvillim të turizmit. Disponon me atraksionet natyrore të begatshme, me lokacione gjeografike të volitshme. Disa prej përparësive të saj turistike të veçanta janë veçoritë e dallueshme morfologjike, hidro-grafike, klimatike dhe elemente të tjera atraktive të cilat e bëjnë Kosovën një nder hapësirat turistike më tërheqëse në rajon. Edhe pse Kosova nuk posedon disa faktorë, të cilët kanë ndikim tërheqës, në pjesën më të madhe të kërkesës turistike, siç është deti, ajo disponon me potencial të jashtëzakonshëm natyror dhe mundësi tjera për zhvillimin e gati të gjitha formave të turizmit, në radhë të parë, të turizmit dimëror-sportiv, malorë, shëndetësorë, transit, gjuetisë turizmit të biznesit etj. Studimet e bëra kanë treguar se në Kosovë ekzistojnë mundësi për ndërtimin e 20 qendrave të turizmit dimëror, të cilat mund të ofrojnë kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv, sipas standardeve ndërkombëtare. Grykat, kanjonet dhe shpellat si motive turistike janë atraksione turistike që paraqesin formë të ngushta relievore të maleve që kanë anë vertikale. Estetika dhe kurioziteti që disponojnë grykat i bëjnë këto atraksione për turizëm. Edhe qafat malore hyjnë në kategorinë e grykave. Në Kosovë ekziston numër i konsiderueshëm i grykave, shpellave dhe kanjoneve. Alpet shqiptare dhe masivi i Sharit janë rajonet më të pasura me gryka, shpella dhe kanjone. Grykat. Më të njohura në Kosovë janë: Gryka e Rugovës, e Kaçanikut, Carralevës, Ibrit etj. Gryka e Rugovës me bukuritë e veta natyrore është gryka më e njohur në rajon dhe më gjerë. Në Kosovë kanjoni më i njohur është kanjoni i Mirushës, i cili ka sistem prej 13 ujëvarave dhe 16 liqeneve të mëdhenj dhe të vegjël me një bukuri madhështore. Shpellat. Paraqesin formë gjeomorfologjike për relievin, në turizëm kanë rol të veçantë për arsye se vizitat që iu bëhen kanë karakter turisti. Në Kosovë përveç shpellës së Gadimes ka edhe shpella tjera, të cilat ende nuk janë të përgatitura për t'u vizituar nga turistët si: shpella e Radavcit, e Panorcit, Petreshticës, Bresalcit, në Grykë të Rugovës etj. Elementet hidrografike, janë element mjaft i rëndësishëm i trashëgimisë natyrore të një vendi. Përmes ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore mund të tregohet kompleksi natyror i përbërjes gjeologjike, relievit, klimës, florës dhe faunës si dhe aktivitetit të njeriut për përshtatjen dhe shfrytëzimin e elementeve hidrografike për plotësimin e nevojave të ndryshme¹⁴

II.3. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Zhvillimi i qëndrueshëm është bërë kryefjalë në diskursin e zhvillimit, pasi që shoqërohet më me përkufizime, kuptime dhe interpretime të ndryshme. Edhe pse përkufizimet janë të shumta në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm, përkufizimi më i cituar i zhvillimit të qëndrueshëm është ai i propozuar nga Raporti i Komisionit Brundtland (Schaefer & Crane, 2005). Pra, definicioni më i përdorur për zhvillimin e qëndrueshëm është ai i dhënë në Raportin e Komisionit Botëror për Mjedis dhe Zhvillim (1987)¹⁵, ku thuhet: Zhvillimi i qëndrueshëm është

¹³ Millaku, Bedri; Reçica, Fetah "Ekonomia e turizmit" fq.73,74. Prishtinë 2011.

¹⁴ Bajrami Halil, Bazat e turizmit ligjërata 2007 Prishtinë

¹⁵ Komisioni Botëror për Mjedis dhe Zhvillim, i njohur gjithashtu si komisioni Brundtland pas kryetarit të tij, Gro Harlem Brundtland u thirr nga Kombet e Bashkuara në vitin 1983, për të adresuar shqetësimin në rritje " në lidhje me përkeqësimin e përshpejtuar të mjedisit njëzori dhe burimeve natyrore dhe pasojat e atij përkeqësimi për zhvillimin ekonomik dhe social.

një process për të përmbushurë nevojat e së tashmës pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhëshëm për t'i përmbushur nevojat e tyre¹⁶.

II.4.RENDËSIA E PUNËSIMIT NË TURIZËM

Turizmi ka rendesi për ekonomin dhe zhvillimin e vendit sepse ndikon në punësim. Turizmi si veprimtari ekoomike ndikon në bilancet vendore e cila si veprimtari e ekonomisë ndikon në punësim i cili është edhe baze për sigurimin e prespektives se mirëqenies sociale të popullsisë në secilin vend. Në turizëm çdo hërë duhet të orientohemi që të hapen më shume vende punë po ashtu edhe orari të jetë sa me i gjatë¹⁷.

II.5. RENDËSIA E KOHËS SE LIRE PËR TURIZMIN

Zhvillimi i turizmit si aktivitet ekonomik nuk mund të paramendohet pa kohën e lirë. Jeta njerëzore dhe përditshmeria e aktiviteteve njerëzore ndikojnë në domosdoshmërinë për kohën e lire. Klasifikimi i kohës së jetës njerëzore mund të ndahet në tri cikle te jetës si të domosdoshme për njeriun. Në rendin e parë hynë koha e jetës natyrore ose ndryshe siç quhet biologjike, në grupin e dytë përfshihet koha e punës dhe në grupin e tretë përfshihet koha e lirë. Në grupin e parë përfshihet koha të cilën njeriu e shfrytëzon për plotësimin e nevojave të veta të natyrshme siç janë; ushqimi, fjetja si dhe nevojat fiziologjike. Kjo tërësi ka të bëjë edhe me nevojat familjare të cilat njeriu e ndërldhin me aktivitetin familjar. Në grupin e dytë si pjesë e aktivitetit njerëzor përfshihet koha e punës. Ne këtë rast përfshihet njesia kohore të cilën njeriu në vendin e punës e kalon të cilën e ka kohë të obliguar. Në grupin e tretë përfshihet koha e lirë e cila përfshinë kohën në të cilën njeriu është pa obligime, pa angazhim në punë apo procesin e prodhimit. Koha e lirë ndahet në kohën e lirë në fund të ditës-orarit të punës, ne kohën e lirë në fund të javës siç është vikendi dhe në kohën e lirë e cila përfshinë kohën e pushimit vjetor. Fjala koha e lirë vjen nga latinishtja LICET, është ajo periudhe ku njeriu i takon vetes, ku ndihet pa obligime për punë¹⁸. Turizmi tani njihet gjerësisht si një fenomen social, pasi natyra e shoqërisë në vendet më të zhvilluara tani ka ndryshuar nga ajo që e ka karakterizuar tradicionalisht një ekonomi të bazuar në industri përpunuese dhe nënprodhim, në atë ku forma dominuese e punësimit janë shërbimet dhe industritë e konsumit¹⁹.

¹⁶ Tahiri, Alberta; Kovaçi, Idriz, "Turizmi i qëndrueshëm " fq.22,23. Prishtinë 2022.

¹⁷ Selimaj, Afrim; Millaku, Bedri; Dreshaj, Adem "Ekonomia e turizmit dhe biznesi" fq.88, 89. Pejë, 2019.

¹⁸ Millaku, Bedri; Reçica, Fetah "Ekonomia e turizmit" fq.75,76. Prishtinë 2011.

¹⁹ Tahiri, Alberta; Kovaçi, Idriz, "Turizmi i qëndrueshëm" fq.192. Prishtinë 2022.

II.6.TURIZMI DHE MJETET E LIRA

Mjetet e lira janë faktor i rëndësishëm të cilat janë në disponim të njeriut. Për mjetet e lira njeriu vendos që t'i shfrytëzoj sipas dëshirës së tij. Pjesa e mjeteve të lira krijohen nga të ardhurat personale të individit i cili është i angazhuar në vendin e punës. Zhvillimi i gjithëmbarshtëm ekonomik me të cilin përfshihet edhe ngritja e të ardhurave personale shprehin me efektin e tyre në qarkullimet turistike. Qarkullimet e tilla ndikojnë në konsumin turistik. Njeriu po sa të plotësoj nevojat e domosdoshme një pjesë të mjeteve të fituar nga puna e tij i ndan për rekreacion dhe pushime. Si bazë që ndikon në turizëm është konsumi turistik i cili paraqitet si kategori shoqërore dhe ekonomike e cila krijohet në kushtet e ndryshme të vendeve të botës. Mjetet e lira paraqesin bazën fillestare të cilat ndikojnë në masën e kërkesave turistike në raport me konsumin turistik i cili ngritët në favor të qarkullimeve turistike²⁰.

²⁰ Reçica, Fetah; Millaku, Bedri "Ekonomia e turizmit" fq.78. Prishtinë 2011.

KAPITULLI III

III.1.RESURSET TURISTIKE

Kosova edhe pse nuk ka det, ka mjaftë resurse turistike që krijojnë mundësin për zhvillimin e llojeve të tjera të turizmit, trashëgiminë kulturore dhe natyror që i krijojnë mundësi për të investuar dhe për krijimin e një produkti turistik atraktiv për turistët. Vështruar nga aspekti i turizmit, Kosova është e përbërë prej pesë rajoneve turistike: Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare, Maleve të Sharrit, Rajoni turistik i Prishtinës, Rajoni turistik i Mitrovicës (Shalës së Bajgorës), Rajoni turistik i Anamoravës. Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare dhe rajoni turistik i Maleve të Sharrit, janë rajone që dallohen jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon me mundësit që ekzistojnë për zhvillimin e turizmit malor e sidomos të atij dimroro-sportiv. Studimet e deritanishme të bëra nga institucione vendore dhe ndërkombëtare tregojnë se vetëm në këto dy rajone turistike ekzistojnë kushte për ngritjen e më se 20 qendrave turistike sipas standardeve ndërkombëtare për zhvillimin e turizmit dimroro sportiv . Edhe tri rajonet tjera turistike kanë specifikat e veta që janë atraktive për zhvillimin e llojeve të caktuara të turizmit. Kosova është e pasur edhe e njohur edhe me atraksione tjera turistike siç janë: Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Ujëvara e Mirushës, numër i konsiderueshëm i burimeve termale, (Banja e Pejës, Killokotit, e Mitrovicës etj),një mori shpellash ndër to duhet veçuar Shpellën e Gadimës, Bifurkacioni i lumit të Nerodimës etj²¹

III.2. RAJONET TURISTIKE

TABELA 4. Rajonet turistike.

Numri	Përshkrimi
1.	Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare
2.	Rajoni turistik i Maleve të Sharrit
3.	Rajoni turistik i Prishtinës
4.	Rajoni turistik i Mitrovicës apo Shalës së Bajgorës
5.	Rajoni turistik i Anamoravës

²¹ <https://drejtesia.blogspot.com/2007/08/turizmi-n-kosov.html>

III.3. RESURSET TURISTIKE NATYRORE

Kosova është e pasur më shumë resurse natyrore që e bëjnë një vend të veçant dhe mjaftë tërheqës për vizitorët. Këto resurse përfshinë male të larta, grykëderdhje të thella, liqene, shpella mahnitëse dhe shumë më tepër.

TABELA 5. Majat kryesore në Kosovë.

Majat kryesorë	Lartësia
Gjeravica	2656m
Bistra	2640m
Marjashi	2530m
Luboteni	2496m
Koproniku	2460m
Strellci	2377m
Maja e Lumëbardhit	2335m

TABELA 6. Lumenjet kryesor të Kosovës

Lumenjët kryesor	Gjatësia
Drini i Bardhë	122km
Sitnica	90km
Lumëbardhi i Pejës(Bistrica)	62km
Morava e Binçës	60km
Lepenci	53km
Ereniku	51km
Ibri	42km
Lumëbardhi i Prizrenit	31km

TABELA 7. Liqenet natyrore të Kosovës

Liqenet natyrore
Liqeni i Madh
Liqeni i Vogël
Liqeni Leqenatit
Liqeni Moknës
Liqeni i Livadhit
Liqeni i Bogovinës
Liqeni i Zi
Liqeni i Jazhincës
Liqeni i Sipërm

TABELA 8. Liqenet artificiale të Kosovës

Liqenet artificiale	Siperfaqja
Liqeni i Gzivodës	9.1 km ²
Liqeni Radoniqit	5.96 km ²
Liqeni i Batllavës	3.27 km ²
Liqeni i Badovcit	2.57 km ²

TABELA 9. Grykat dhe kanjonet e Kosovës

Grykat
Gryka e Rugovës
Gryka e Kaçanikut
Gryka e Lumbardhit
Gryka e Carralevës
Kanjoni i Mirushës

TABELA 10. Disa nga shpella e Kosovës

Shpella
Shpella e Gadimes
Shpella e Radavcit
Shpella e Petreshnices
Shpella e Panorcit
Shpella në Grykë të Rugovës
Shpella ne Brestalc etj

TABELA 11. Burimet termo-minerale të Kosovës

Burime në shfrytëzim	Burime të pashfrytëzuara
Banja e Klllokotik	Burimi i Uglarit
Banja e Pejës	Burimi i Kmetocit
Banja e Banjeskës	Burimi në Poklek
Banja e Malishevës	Burimi në Lluzhan
	Burimi i Pediqit

III.4. DESTINACIONET TURISTIKE NË KOSOVË

Destinacionet janë qendrore në pervojën e turizmit dhe për këtë arsye, u paraqesin studiuseve një game të madhe çështjesh për të shqyrtuar. Destinacione njohen si arsyeja apo qëllimi kryesor për zhvillimin e turizmit, ato plotësojnë nevojën për të udhëtuar dhe janë atraksionet në destinacion ato që krijojnë motivimin për të ndermarrë vizita në ato destinacione. Destinacionet gjithënjë e më shumë njihen si një përzierje të produkteve, objekteve dhe shërbimeve që përfshijnë “produktin total të turizmit ose “pervojën e udhëtimit”²². Vetë rajonet shpesh funksionojnë si destinacione të veçanta. Destinacionet mund të gjenden edhe si burime individuale ose hapësira urbane²³.

Destinacionet turistike janë vende që tërheqin vizitorë për shkak të bukurisë natyrore, rëndësisë historike, ofertës kulturore ose atraksioneve të tjera unike.

Disa nga destinacionet turistike në Kosovë:

III.4.1. Shpella e Kusarit

Shpella e Kusarit është një ndër destinacionet më të veçanta të Kosovës. Sipas gjetjeve arkeologjike, kjo shpellë ka qenë e banuar në kohën e eneolitikut. Kjo shpellë gjendet 1 km larg fshatit Kusar në Gjakovë dhe ndodhet në një terren malor të Maleve të Pashtrikut. Shpella e Kusarit karakterizohet me një terren të shkëmbor dhe të gjelbëruar, tek e cila vizitorët mund të ecin deri në brendësi të saj dhe të shijojnë pamjet magjepëse gjelbërore që kjo shpellë ofron për vizitorët e shumtë.

Edhe pse në vend malor, vlen të ceket se ju mund të udhëtoni me veturë deri tek destinacioni dhe pastaj të ecni 10 min deri tek shpella pasi rruga deri aty është e asfaltuar dhe në gjendje të mirë.

III.4.2. Drini i Bardhë

Ujëvara e Drinit të Bardhë është një ndër atraksionet më të vizituara të komunës së Pejës. Burimi i Drinit të bardhë është një nga ujëvarat më të bukura të Kosovës, e cila përveç që është atraksion turistik, furnizon qytetin e Pejës me ujë të pijes.

Rrugëtimi për tek Drini i Bardhë mund të bëhet nga 2 qasje. Qasja e parë të shpie nga restaurant “Ujëvara e Drinit” nga e cila pastaj duhet të ndiqni shtegun e ecjes përgjatë lumit, ndërsa qasjen tjetër tek Ujëvara e Drinit bëhet nga restaurant “Trofta e Drinit”, qasje kjo e cila ju lejon të afroheni me makinë deri tek shtegu dhe pastaj të ecni në këmbë deri tek Ujëvara.

²² Kovaçi, Idriz; Tahiri, Alberta “Turizmi i Qëndrueshëm “. Fq. 184.

²³ Koja, Vita; Gorica, Klodiana “Marketingu i Turizmit” fq.113.

III.4.3. Kalaja e Prizrenit

Kalaja e Prizrenit është monumenti më i njohur i trashëgimisë kulturore dhe simboli i qytetit të Prizrenit. Kalaja është ndërtuar në një kodër të lartë nga e cila shihet i gjithë qyteti i prizrenit si në pëllëmbë të dorës.

Rruga për në kala merr 15 minuta ecje në këmbë. Ju duhet të ndiqni një rrugicë nga qendra e qytetit e cila të shpie lartë në kala, tek e cila ju do të magjepseni me pamjen piktoreske të qytetit të Prizrenit, si dhe me ndërtimet e bëra në kala së fundmi.

III.4.4. Liqenet e Mirushës

Të gjendur në fshatin Rudë në komunën e Malishevës, Ujëvarat e Mirushës, ndryshe njohur edhe si Park Regjional i Natyrës, janë një ndër destinacionet më të bukura të Kosovës. Kjo zonë karakterizohet me një numër të madh të liqeneve me forma dhe madhësi të ndryshme duke përfshirë 16 liqene dhe 12 ujëvara.

Përveç se do të përjetoni pamjen magjepsëse të liqenit të madh, ne ju rekomandojmë që të ngjiteni më lartë dhe të shihni të gjithë liqenet që ndodhen në këtë zonë dhe të kompletoni pamjet piktoreske që Ujëvarat e Mirushës ofrojnë për vizitorët.

III.4.5. Ulpiana

Ulpiana – Qyteti Romak, i themeluar në fillim të shekullit II nga perandori Trajan, konsiderohet të jetë një nga vendet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Qyteti antik i Ulpianës ndodhet në Graçanicë, Kosovë dhe është i rrethuar me mure të gjëra deri në 3m dhe me nga dy kulla gjysmërrethi. Ulpiana ka sipërfaqe prej 35,5 ha dhe sipas gjetjeve arkeologjike ky qytet ndodhej afër qytetit të sotshëm të Lipjanit, madje supozohet që ky qytet mund edhe të identifikohet me po këtë qytet.

III.4.6. Shpella e Gadimes

Shpella e Gadimes ndodhet në fshatin Gadime të komunës së Lipjanit. E njohur për dukuritë dhe pamjet interesante që ofron, shpella e Gadimes është shpella e vetme e përgatitur për vizitorë në Kosovë.

Shpella përmban detaje mjaft interesante si kristale, rezonanca në stalaktit me të cilat mund të luani melodi, stalagmite, aragonite nëntokësore si dhe mure shumëngjyrëshe të cilat bëjnë që eksperiencia juaj brenda shpellës të mos harrohet shpejtë.

Në brendësi të shpellës ndodhet gjithashtu edhe një liqen, i njohur si Liqeni i Fortunës në të cilin turistët hedhin para për realizimin e dëshirave.

III.4.7. Gryka e Rugovës

Gryka e Rugovës, njohur ndryshe edhe si kanionët më të gjata dhe më të thella të Kosovës gjendet afër qytetit të Pejës në Bjeshkët e Nemuna.

Gryka e Rugovës përbëhet nga disa ujëvara dhe burime uji siç është Uji i Zi dhe Kroj. Kjo pjesë gjithashtu përmban një urë harkore e cila lidh kanionin dhe tërheq mjaft shumë vizitorë të huaj nga e gjithë Kosova pasi është terren i përshtatshëm për ngjitje, piknik me familje, alpinizëm, bjeshkatari, etj.

III.4.8. Pylli i arinjve Prishtina

Për të gjithë të apasionuarit pas arinjeve, strehimorja e arinjeve Bear Sanctuary Prishtina, e cila gjendet në fshatin Mramor afër liqenit të Badovcit në Prishtinë ju mundëson të shihni nga afër arinj të strehuar në këtë strehimore. Bear Sanctuary Prishtina numëron gjithsej 20 arinj të cilët tashmë zhvillojnë jetën e tyre në këtë territor.

Bear Sanctuary është i hapur për vizitorët dhe ofron zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për fëmijë, evente të ndryshme si dhe restaurante. Eksplorimi i arinjve në strehimore drejtohet nga ekspertët e fushës të cilët ndajnë fakte dhe detaje për arinjët e kaftë që ndodhen aty.

III.4.9. Kalaja e Artanës

Kalaja e Artanës, ndryshe njohur edhe si Kalaja e Novobërdës ndodhet një mal të vogël ndërmjet Përlepnicsës dhe Kricarekës në perëndim të Gjilanit. Në këtë kala, ruhen rrënojat e qytetit mesjetar të Novobërdës në të cilin kanë banuar mbi 50 mijë banorë.

Kalaja e Artanës përbëhet nga kalaja e sipërme dhe kalaja e poshtme. Kalaja e sipërme ka gjithsej 6 kulla, atë lindore dhe perëndimore të cilat kanë bazë drejtëkëndëshe ndërsa të tjerat kanë bazë katrore.

III.4.10. Liqenati

Liqeni i Kuqishtes, ndryshe i njohur edhe si Liqenati ndodhet në Bjeshkët e Nemuna të cilat shtrihen në pjesën perëndimore të Kosovës. Liqenati ndodhet në një lartësi mbidetare 1.970m mbi nivelin e detit. Pavarësisht kësaj, ky liqen vizitohet nga turistë dhe alpinistë të shumtë të cilën ngjiten në majet e maleve. Për të shkuar tek Liqenati, ju duhet të afroheni me veturë deri tek restoranti “Guri i Kuq” dhe pastaj të vazhdoni në këmbë duke ndjekur shtegun deri tek Liqenati. Ndiqni shenjat nëpër drunj pasi ato tregojnë drejtimin që duhet të ndiqni për tek Liqenati²⁴.

²⁴ <https://spektri.tv/10-vendet-turistike-ge-duhet-vizituar-ne-kosove/>

KAPITULLI IV

IV.1. MUNDËSITË E INVESTIMIT NË KOSOVË

Kosova ka një numër të sektorëve që ofrojnë mundësi të mira të biznesit siç janë:

IV.1.1 Rendësia e Energjisë dhe minierave në Kosovë

Kosova disponon me resurse të shumta natyrore, vlerësohet të ketë rreth 12.5 miliardë tonelata me rezervave të linjtit duke zënë vendin e pestë në botë me rezervat e kësaj xeheje. Rezervat e linjtit përdoren si burim kryesor i prodhim it të energjisë në Kosovë dhe vlerësohet të zgjasin për 650 vitet e ardhshme, me ritmin e nxjerrjes aktuale. Rezervat e linjtit janë gjithashtu të shpërndara në basenin e Dukagjinit dhe Drenicës, por nxjerrja e xehes aktualisht është e kufizuar vetëm në basenin e Kosovës. Përveç linjtit, Kosova është gjithashtu e pasur me minerale të tjera si: alumini, ari, plumbi, zinku, bakri, boksiti, magnezi, azbesti, kromi, guri gëlqeror, mermeri dhe kuarci, zinku, çeliku, ari, kadmiumi, dhe bizmuti. Siç vlerësohet nga Banka Botërore, Kosova ka rezervat e mëdha të resurseve natyrore të cilat ende mbeten të pashfrytëzuara, ndërsa janë potencial i madh për rritje në të ardhmen. Minierat Trepça: rreth 23,000 të punësuar, një kohë ishte ndër kompanitë më të mëdha në ish-Jugosllavi ²⁵.

IV.1.2 Kapaciteti energjetik në Kosovë

Pjesa më e madhe e furnizimit me energji të Kosovës bazohet kryesisht në linjit²⁴. Aktualisht janë në funksionim dy termocentrale, Kosova A (5 njësi me 800 MW të instaluar) dhe Kosova B (dy njësi me 678 MW të instaluar). Kapaciteti aktual i këtyre impianteve është rreth 915 MW në tërësi. Qeveria është zotuar se do e mbyllë në një mënyrë të pranueshme ekonomisht, ambientalisht, dhe shoqërisht Termocentralin 50 vjeçar Kosova A i cili ndotë shumë ambientin, por kjo do të rrisë zbrazëtimin e furnizimit me energji elektrike²⁶.

²⁵ <https://www.kas.de/documents/286052/0/19-12-24+Foreign+Direct+Investment+in+Kosovo+-+The+Investment+Climate%2C+Potential+and+Barriers+%28ALB%29.pdf/22d365b2-08dc-27f5-d35b-f2c17e1b184e?version=1.0&t=1580216557431>

²⁶ [Kosova e Re lignite power plant, Kosovo - Bankwatch](#)

IV.1.3 Bujqësia dhe blegtoria ndikimi i tyre në ekonomi

Kosova është e pasur me tokë bujqësore; 53 për qind e sipërfaqes totale është tokë e punueshme. Aktualisht, sektori bujqësor kontribuon me vetëm 19 për qind të gjithsej njësisë vjetore të punës dhe 15 për qind të vlerës së eksportit. Përpunimi i ushqimit në Kosovë është menaxhuar tradicionalisht nga ndërmarrjet shoqërore, ndërsa sot ato janë joaktive; ndërmarrjet e reja private kanë filluar të operojnë në këtë fushë. Shumica e këtyre kompanive janë të vogla dhe nuk kanë kapacitet të plotësojnë pjesën më të madhe të kërkesave në treg. Investimi në këto kompani, sigurimi i teknikave të reja të menaxhimit mund të rigjallërojë industrinë e agro-përpunimit në Kosovë në atë masë sa të jetë konkurruese në tregjet ndërkombëtare. 7.4 Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi – TIK Qeveria e Kosovës ka njohur rëndësinë strategjike të industrisë së TIK-ut për zhvillimin ekonomik dhe transformimin strukturor drejt një ekonomie të bazuar në dije. Si rezultat, në 2013 Qeveria e Kosovës zyrtarisht e shpalli industrinë e TIK-ut sektor me përparësi të lartë për ekonominë e saj. Sipas një Ankete të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të botuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)²⁷.

IV.1.4 Përpunimi i drurit dhe zhvillimi i eksportit

Mbi 40% e tokës së Kosovës është e mbuluar me pyje, ose një sipërfaqe prej rreth 465.000 hektarë. Përpunimi i drurit konsiderohet si një nga sektorët më strategjikë me potencial të madh për rritje. Vëllimi total i tokës pyjore publike dhe private vlerësohet të jetë rreth 53 milionë m³. Të dhënat statistikore tregojnë se 75% e kompanive të përpunimit të drurit prodhojnë produkte finale; 18% prodhojnë produkte të ndërmjetme (gjysmë-finale), dhe 10% prodhojnë lëndën e parë. Shumica e kompanive të përpunimit të drurit kanë pasur tregues pozitiv në vitet e fundit (ritje pozitive në qarkullim, prodhim me vlerë të shtuar, rritje në numrin e të punësuarve, rritje në eksport). Destinacionet kryesore të eksportit: Gjermania, Austria dhe Zvicra (kryesisht dyer, dritare, kuzhi na dhe orendi), si dhe vendet e tjera të rajonit²⁸

IV.1.5 Niveli dhe rendësia e ndërtimitarisë në Kosovë

Viteve të fundit industria e ndërtimit është bërë ndër sektorët më të rëndësishëm në ekonominë kosovare. Ky sektor vazhdon të ketë potencial shumë të madh ekonomik për Kosovën, duke marrë parasysh nevojën për ndërtime të vendbanimeve të reja dhe infrastrukturës rrugore. BPV nga ndërtimtaria në Kosovë ishte mesatarisht 101.49 milionë euro nga 2011 deri në 2019, duke

²⁷<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf> fq.36

²⁸<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf> fq.37

arritur shumë më të madhe ndonjëherë prej 195.70 milionë euro në tremujorin e dytë të 2019 dhe rekord të ulët prej 34.10 milionë euro në tremujorin e parë të 2011 ²⁹.

IV.1.6 Turizmi dhe rendësia direkte në ekonomi

Pasuritë natyrore të Kosovës paraqesin burim të kualitetit të lartë për turizëm. Jugu malor i Kosovës ka potencial të madh për turizmin dimëror. Një nga mundësitë më interesante për investitorët e huaj në këtë rajon është Qendra e Skijimit në Brezovicë, në malet e Sharrit. Kjo qendër gjendet mes 1,700 dhe 2,500 m lartësi mbidetare. Ai ofron kushte të shkëlqyeshme të motit dhe borës si dhe sezon të skijimit nga nën tori deri në maj. Brezovica mund të arrihet për një orë me makinë nga dy aeroporte ndërkombëtare, Aero porti i Prishtinës (60 km) dhe i Shkupit (70 km), dhe gjendet në Parkun Kombëtar të Sharrit në Republikën e Kosovës, vargmalet e Brezovicës shtrihen në 39,000 hektarë me terren të lartë malor alpin dhe pyje. Po ashtu, në Malet e Sharrit, në pjesën më jugore në kufi me Maqedoninë dhe Shqipërinë, Kosova ofron për privatizim rreth 22,000 hektarë të tokës së pashkelur në pjesët malore që i përka sin NSH “Sharrprodhimi”. Ky rajon ofron mundësi të shkëlqyeshme për turizëm si: skijimi, eko-turizmi, lëshimet me parashutë nga lartësitë malore, çiklizmi malor, ngjitja në shkëmbinj, ecja alpine, lundrimi me kajak, kalërimi, etj. Toka në Komunën e Dra gashit ka bukuri magjepsëse. Ajo paraqet mundësi të jashtëzakonshme për eko-turizëm. Mundësi tjetër për investime është Qendra e Skijimit në Bjeshkët e Rugovës. Kosova është kryesisht e pasur me male, liqene artificiale dhe lumenj, gjë e cila ofron mundësi të mira për gjueti dhe peshkim. Zeja e përhapur e punimeve artizanale në Kosovë, siç është Filigrani (me argjend), paraqet atraksion për turistët e huaj. Përveç kësaj, Kosova ka potencial për zhvillimin e turizmit kulturor me objekte të ndryshme relig jioze me vlerë të jashtëzakonshme kulturore dhe historike. Janë të njohura burimet e famshme termale të Kosovës, për shkak të efekteve shëruese të tyre. Për këtë lëmi, investitorët e huaj do të gjejnë kërkesë të madhe në tregun rajonal dhe atë të brendshëm. Për më shumë, ju lutemi vizitoni faqen e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në internet³⁰.

²⁹<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf> fq.37

³⁰ <https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf> fq.37,38.

IV.2. NDIKIMI I COVID-19 NË INVESTIME

Pandemia COVID-19 është definuar si krizë globale e shëndetit dhe sfida më e madhe me të cilën jemi përballur që nga Lufta e Dytë Botërore. Në mbarë botën, që nga 31 dhjetori 2019 deri kah fundi i muajit shtator 2020 numri i rasteve të prekura me Covid-19 i ka tejkaluar 32 milionë raste të konfirmuara, përfshirë 991,224 vdekje, të raportuara në Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH)¹. Duke pasur parasysh përhapjen e shpejtë të pandemisë, vendet në të gjithë botën kanë miratuar disa masa të shëndetit publik që synojnë të parandalojnë përhapjen e tij, duke përfshirë distancimin shoqëror dhe orare të kufizuara lëvizjesh e orë policore si preventive për t'u përballur me valën e pandemisë. Pandemia COVID-19 nuk rrezikon vetëm shëndetin tonë por ka goditur fuqishëm edhe ekonominë e çdo vendi, duke sjellë me vete tronditjen e tretë dhe më të madhe ekonomike e financiare të shekullit 21 (krizë më e madhe se ajo e 11 shtatorit dhe krizës globale financiare të vitit 2008)³¹.

IV.3. OBJEKTET HOTELIERE DHE RRITJA EKONOMIKE

Të gjithë objektet hoteliere që kanë bërë kategorizimin me yje të objekteve të tyre hoteliere kanë afat gjashtëmujorë nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ që t'i rikategorizojnë objektet e tyre apo t'i largojnë yjet nga objekti. “Fusha e turizmit është një fushë me potencial për zhvillimin e vendit tonë. Ministria jonë ka në planet e saj edhe shumë projekte tjera madhore në fushën e turizmit, siç është zhvillimi i kompleksit të Qendrës së Skijimit në Brezovicë dhe kështu mendojmë të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në vend”, tha Bernard Nikaj. “Ne po synojmë që të ofrojmë një cilësi më të lartë për turist qoftë vendor apo të ndërkombëtarë që e vizitojnë vendin tonë. Ky është një hap që do të ngritë kualitetin e shërbimeve që ofrohet në sektorin e turizmit”, theksoi u.d i ministrit të Tregtisë³².

³¹ [https://www.kas.de/documents/286052/0/Policy%20Brief%202020-11-18%20Impact%20of%20Covid-19%20on%20Foreign%20Investments%20\(ALB\).pdf/a3692eac-c7e2-fc51-f758-830afd795e1a?version=1.0&t=1609944729267](https://www.kas.de/documents/286052/0/Policy%20Brief%202020-11-18%20Impact%20of%20Covid-19%20on%20Foreign%20Investments%20(ALB).pdf/a3692eac-c7e2-fc51-f758-830afd795e1a?version=1.0&t=1609944729267) fq.5.

³² <https://www.ekonomia.info/sq/turizem/klasifikikohen-dhe-kategorizohen-objektet-hoteliere>

IV.4. KAPACITETI I KOSOVËS PËR TURIZËM

Në zonat turistike, aty ku ushtrohet funksioni turistik, kapacitetet turistike paraqesin segmentet kryesore bartëse me anën e të cilave kryhën shërbimet e vendosjes, ushqimit, të pijeve, të argëtimit të turistëve të ardhur³³. Hoti ka përmendur se Kosova ende ka problem sa i përket pjesës së akomodimit në numër të madh të vizitorëve kryesisht gjatë aktiviteteve dhe festivaleve duke i veçuar "Mani Festen" dhe "Sunny Hill" të cilët do të sjellin një numër të madh të vizitorëve, "Kosova ka papacitete sa i përket zhvillimit të turizmit duke pasur parasyshtë pozitën gjeografike dhe vendet atraktive të cilat i ka, duke ju ofruar dhe duke qenë një vend atraktiv për turistët, e sidomos vendet malore që çdo ditë e më tepër po frekuentohen nga grupet e ndryshme të turistëve. Kosova ende ka problem sa i përket pjesës së akomodimit në numër të madh të vizitorëve kryesisht gjatë aktiviteteve dhe festivaleve siç i kemi tashmë në kryeqytet "Mani Festen" dhe "Sunny Hill" të cilët do të sjellin një numër jashtëzakonisht të madh të vizitorëve në kryeqytet", ka shtuar Hoti. Sipas tij, problematikat në sektorin e turizmit në Kosovë janë po të cilat na përcjellin me vite të tëra. Sfidë e madhe në sektorin e turizmit në Kosovë mbetet edhe stafi dhe kuadrot profesionale³⁴.

TABELA 12. Kapacitetet hoteliere në Kosovë 2020-2023

	Hotele	Motele	Bujtina	Hostele	Apartamente	Bungallo	Gjithsej
	Dhoma	Dhoma	Dhoma	Dhoma	Dhoma	Dhoma	Dhoma
2020	4708	2142	60	59	25	374	7368
2021	4873	2160	60	59	25	374	7551
2022	4873	2160	60	59	25	374	7551
	6610	2047	53	55	25	403	9193

Burim: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS.

³³ Gashi, Musa "Bazat e turizmit" fq.190. Prishtinë 1986.

³⁴ <https://rtv21.tv/turizmi-ne-kosove-kapacitetet-dhe-problemet/>

IV.5. INFRASTRUKTURA NË KOSOVË

TABELA 13. Llojet e infrastruktures në Kosovë.

1	Infrastruktura Rrugore
2	Infrastruktura Hekurudhore
3	Infrastruktura Ajrore

IV.5.1. Infrastruktura Rrugore

Territori i Kosovës ka një infrastrukturë rrugore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme biznesore. Rrjeti rrugor përbëhet prej 630 km rrugë kryesore. Infrastruktura rrugore e vendit është e zhvilluar mirë. Ekziston një rrjet rrugësh i zhvilluar plotësisht, përgjithësisht rrugët janë me kushte shumë të mira. Shumë rrugë kryesore lidhin qytetet e mëdha të Kosovës. Përgjegjës për mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale dhe regjionale është Ministria e Infrastrukturës ndërsa për rrugët lokale përgjegjëse është Komuna.

IV.5.2. Infrastruktura Hekurudhore

Kosova posedon një sistem hekurudhor prej 330 km që mbulon tërë territorin e Kosovës duke lidhur veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin. Sistemi Hekurudhor përveç transportit të pasagjerëve për qëllime private dhe zyrtare ofron edhe transportin e mallrave të ndryshme për qëllime të bizneseve, në Kosovë dhe jashtë saj. Një transport i tillë realizohet jo vetëm përmes hekurudhës por edhe në kombinim me lloje tjera të transporteve.

IV.5.3. Infrastruktura Ajrore

Kosova posedon një aeroport të vetëm, Aeroportin Adem Jashari, i cili është njëri prej aeroporteve më të frekuentuara në regjion. Ky aeroport ofron fluturime në qendrat më të rëndësishme Evropiane por edhe në Amerikë³⁵.

³⁵ <https://kosovo-mining.org/kosova/infrastruktura/>

KAPITULLI V

V.1. RËNDËSIA E PROMOCIONIT

Promocioni ka rendesi të veçant në turizem për arsye se ofron nxitje për të blerë, nxitje duke përfshirë mjete të ndryshme për nxitje si, oferta, ulje të çmimeve të tjerë, me qëllim të tërheqjes së klienteve apo turistave të rinjë, duke shpërblyer edhe besnikërit e tyre. Promocioni është kombinimi më i përshtatshëm i të gjitha elementëve të promovimit të produkteve dhe të shërbimeve dhe mund të quhet edhe miks promociional.

Komunikimi efektiv me konsumatorët e synuar realizohet nëpërmjet disa metodave, të cilat i referohen komunikimit marketing. Për shumë njerëz marketingu është promovim.

Roli i promovimit në turizëm merr në konsideratë shumë teknika promovuese,

- publicitetin;
- broshurat;
- shtypin dhe marrëdhëniet publike;
- promocionin e shitjeve;
- shitjet personale;
- sponsorizimet;
- pikat e shitjes;³⁶.

V.2.RËNDËSIA E MARKETINGUT

Marketingu në turizëm është thelbësor për të tërhequr vizitorët dhe për të promovuar destinacionet turistike. Për të pasur një strategji të suksesshme marketing në turizëm duhet të ; Hulumtojmë tregun, përdorimi i mediave sociale, markimi i destinacionit, Kampanjat e reklamimit, pjesëmarrja në panairë dhe evente, marrëdhëniet me publikun, oferta dhe paketa speciale, analiza dhe përmisimi i vazhdueshëm. Llojet e marketingut të cilat janë më të përdorura;

- Marketingu Dixhital;
- Marketingu në Mediat Sociale
- PPC (play per click)
- Marketingu përmes Email-it
- Marketingu përmes Mobile

Këto janë disa nga llojet e marketingut që po përdoren më shumë për shkak të aftësisë së tyre për të arritur dhe angazhuar konsumatorët në menyra efektive dhe të matshme. Teknologjia dixhitale ka revolucionizuar mënyrën se si bizneset komunukojnë dhe ndërveprojnë me audiencat e tyre.

³⁶ Koja, Vita; Gorica, Klodiana "Marketingu i Turizmit" 2007 fq.189.

V.3 RËNDËSIA E AKTIVITETEVE TURISTIKE NË EKONOMI

Rëndësia e turizmit për ekonominë sot është mjaft e madhe, Duke u bazuar në qarkullimet turistike më përmasa botërorë, me të vërtet, janë treguesit më të mire nga të cilët ndikon turizmi në veprimtaritë ekonomike. ³⁷Gjithëashtu treguesi më i mirë është numri i vizitoreve apo turistëve të cilet kan vizituar vendin.

TABELA 14. : Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netëqendrimet 2019-1023

	2019		2020		2021		2022		2023	
	Vizitorët	Netët	Vititorët	Netët	Vizitorët	Netët	Vizitorët	Netët	Vizitorët	Netët
Albania	34720	61803	30977	48448	55 591	75887	63775	107691	90518	191575
Germany	18 482	40092	8 422	18203	25 671	52435	34 521	68 707	41 105	98 156
US	10 370	19295	2 946	5 282	8 433	13500	13 180	24 311	15 780	27 607
Turkey	14 796	23448	6 380	9 388	10 907	19049	17 490	27 917	23 482	40 315
Macedonia	7 253	10948	3 389	5 578	8 874	12545	11 948	17 054	17 024	40 194
Italy	6 723	11036	2 165	5 759	5 625	15108	8 261	19 879	11 164	24 963
Slovenia	5 422	9 446	1 139	2 409	2 878	5 233	3 664	5 984	3 851	7 229

Burim: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS.

³⁷ Selimaj, Afrim; Millaku, Bedri; Dreshaj, Adem. “Ekonomia e turizmit dhe biznesi” fq.86.

TABELA 15. Numri i vizitorëve në Kosovë

	Vizitorë							
	Gjakovë	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Prishtinë	Ferizaj	Gjithsej
2014	2 062	1 552	2 631	11 534	8 615	77 167	4 229	107 790
2015	2 269	1 635	2 247	21 707	16 316	89 050	6 214	139 438
2016	16 167	6 600	7 185	61 031	47 821	109 400	9 220	257 422
2017	13 560	5 929	9 609	57 312	45 097	107 691	12 092	251 290
2018	14 521	8 604	14 159	75 151	52 465	114 071	12 445	300 803
2019	7 995	8 507	15 765	65 099	55 107	122 541	12 069	287 083
2020	1 603	2 742	13 644	41 519	29 318	55 783	3 935	148 543
2021	4 751	11 698	30 593	72 581	77 150	134 362	24 007	355 141
2022	5 270	15 531	31 317	74 022	103 246	190 947	40 135	460 467
2023	13 021	40 471	39 099	153 803	149 31	175 604	50 177	621 486


Burim: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS.

KAPITULLI VI

VI.1 REZULTATET NGA PYTSORI

FIGURA 1. RAJONI MË I PREFERUAR


Cilin nga rajonet Turistike preferoni me shume
55 responses



Duke u bazuar në përgjigje të marra shumica e responenteve kanë deshmuar se destinacioni i tyre i preferuar është Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare apo bjeshkeve të Nemuna, i cili posedon një histori mjaftë interesante dhe me ambient shumë tërheqës dhe mahnites.

FIGURA 2. NË ÇFARË FORME REALIZOHEN ME SHUMË UDHËTIMËT


Në çfare forme realizoni me shumë udhëtimet
55 responses



Siç shihët respodentët pelqejnë me shumë udhëtimet grupore, po ashtu edhe unë mendoj se udhëtimet grupore janë një mënyrë e shkëlqyer për të eksploruar destinacione të reja së bashku me miqtë, familjen, apo kolegët.

FIGURA 3. LLOJI ME I PËRDORUR I UDHËTIMEVE.

Cilin lloj transporti përdorni më shumë në realizimin e udhëtimeve
55 responses



Në lidhje me transportin shihet se respondentet me shumë përdorin Vetura.

Pyetja:4.

A mendoni se ndikon siguria e vendit në mos realizimin e vizitave?

Disa nga respondentet janë shprehur se jo nuk ndikon siguria nese ata do ta vizitojnë një vend kjo gje nuk do ti ndalte apo ti friksonte mirpo shumë të tjerë kanë shprehur mendimin e tyre duke deklaruar se siguria është e para se nuk do ta vizitonin një vend nga frika nese nuk ka siguri, ata i konsiderojnë ato vende të pasigurta. Gjithëashtu unë mendoj qe po ndikon shumë në mënyrë direkte, per arsye se une personalisht nuk do ta vizitoja një vend nese nuk do te kishte siguri apo stabilitet qoft ai ekonomik apo politik.

Pyetja:5.

Sa mendoni së është zhvilluar Kosova në këto 25 vite pas përfundimit të luftës?

Disa nga respondentet u përgjigjen se është zhvilluar pak disa te tjerë mesatarishtë ndersa një përqindje më e madhe pohuan se Kosova ka pasur zhvillim në shumë fusha por në kohen e ardhshme do ketë me shumë investime dhe do jetë me e zhvilluar, disa menonin se është zhvilluar mjaftueshem duke pasur parasysh gjendjen në të cilën gjindeshim pas luftës, një përgjigje tjeter ishte: Shume, ne krahasim me vendet e tjera dhe ne qfre menyre qeveria dhe shteti ka qene i drejtuar, Kosova eshte zhvilluar shumë. Dhe unë mendoj që po është zhvilluar mesatarishtë duke pasur parasysh potencialet turistike qe posedon poashtu ka ende sektore ku duhet te investohet duke përmendur edhe sektorin e infrastrukturës.

Pyetja:6.

A mendoni se koha e pandemis 2019-2021 ka ndikuar negativisht në mos realizimin e projekteve në fushën e turizmit?

Një përqindje e vogël e respondentëve thanë që jo nuk ka ndikuar dhe unë nuk pajtohem më këtë, ndërsa shumica nga përgjigjet e respondentëve ishin se, Po,...mendoj që ajo periudhë ka qenë shumë e vështirë për të gjithë ne dhe në mbarë botën, kemi qenë të izoluar dhe kishim të bënim me një armik të padukshëm që smund ta dinim nga po na vjen...., Koha e pandemis ishte për të gjithë botën një e pa pritur por se solli shumë e shumë të këqia dhe pati shumë ngecje në mos realizimin e projekteve sidomos në shtetin e Kosovës, disa e konsiderojnë atë kohë si një katastrofë të vertetë për arsye se shumë projekte u ndërpreu dhe sot e asaj dite ka shumë projekte që nuk janë finalizuar, kufinjët ishin të bllokuar. Unë mendoj që po ka ndikuar negativisht në mënyrë direkte për arsye se koha e pandemis ishte një kohë mjaft e vështirë jo vetëm për ne por për të gjithë Botën. Inflacion dhe Krizë shumë e madhe.

Pyetja:7.

A mendoni se ruajtja e objekteve të djegura dhe të shkatërruara si pasoje e luftës do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e turizmit, duke tërhequr apo bërë kureshtar shumë turist nga e gjithë Bota. Po/Jo Pse?

Një pjesë e respondentëve tha që jo për arsye se vetëm do të ndotej ambienti, disa të tjerë jo,...sepse nëse do të kishim ruajtur gjitha ato që janë shkatërruar, ne vetëm do të kujtonim traumat e luftës dhe do shpreheshim asnjëherë nga to, me mirë është të vazhdojmë përpara dhe të mos shohim prapa fare, nuk them që ti harrojmë ato që na bëjnë por nuk e shohim të arsyeshme që të mos ecim përpara dhe të mbesim në një vend...Mirpo një përqindje e madhe pohuan se po sepse turistët ju intereson e kaluara e vendit që vizitojnë sidomos shtetin e Kosovës sepse kanë ndëgjuar shumë për luftën se ka ndodhur poashtu kemi shumë objekte të cilat sot vizitohen nga ana e turistëve siq është shtëpia e Adem Jasharit, disa mendojnë që padyshim që po sepse ato ishin dëshmi të luftës dhe sakrificës, disa thonë që vetëm një pjesë e tyre për të parë se qfarë ka përjetuar populli në atë kohë, të mesojnë rreth historisë dhe të kaluarës, gjithashtu disa thanë se nuk kishte plan Urbanistik për të ruajtur objektet e djegura, Për shumë turistë, vizitimi i këtyre objekteve mund të jetë një mënyrë për të mësuar më shumë për historinë e një vendi dhe për të reflektuar mbi

pasojat e konflikteve të meparshme. Gjithashtu dhe unë mendoj që Poo do të ndikont pozitivisht për arsye se kemi mjaft kujtime të dhimbeshme padyshim që do të ishte një gjë e veçant dhe me ane të tyre do të tregonin Botes me Krenari se sa të Forte jemi dhe se ne nuk dorzohemi letë. Duke pasur parasysh faktin se shumë nena krenohen për humbjen e fëmijëve për të Qliruar Vendin tone pavarësisht se sa dhemb.

Pyetja:8.

A mendoni së Kosova do të ketë turizem të qëndrueshëm në 10 vitet e ardhshme?

Mund të themi që të gjithë respondentet janë përgjithur pozitivisht duke shprehur se po do të ketë zhvillim të vazhdueshëm, ku disa thonë që mendojnë edhe të investojnë në këtë fushë duke e parë që edhe shumë autor kanë theksuar që këta dy shekujt e fundit pra shekulli XX-20 dhe XXI-21 po konsiderohen si shekuj të Turizmit.

REKOMANDIME

Kosova ka potencial të madh për turizëm natyror, kulturor, ushqimor dhe aventurier. Diversifikimi i atraksioneve turistike do të ndihmonte në tërheqjen e një shumëllojshmërie vizitorësh.

- Investimi në infrastrukturës: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, ajrore dhe akomoduese do të rritë qëndrueshmërinë dhe komfortin e vizitorëve. Investimi në hotele, restorante dhe qendra informacioni turistike.
- Promovimi i turizmit Malor dhe Rural: Marketingu i destinacionit turistik në nivel ndërkombëtar do të rrisë ndërgjegjësimin dhe interesin për të vizituar Kosovën. Peisazhet malore dhe fshatrat piktoresk të Kosovës ofrojnë mundësi të mëdha për turizmin e natyrës.
- Zhvillimi i kapaciteteve turisike: Trajnimi i personelit në sektorin e turizmit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore do të përmisojë eksperiencën e vizitorëve.
- Mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore: Ruajtja e mjedisit natyror dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të vendit do të ndihmojë në ruajtjen e identitetit të Kosovës dhe tërheqjen e turistëve të interesuar për eksperiencat autentike.
- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm: Për të siguruar që turizmi të ketë një ndikim pozitiv afatgjatë, është e rëndësishme të zbatohet një qasje të qëndrueshme. Kjo përfshin mbrojtjen e resurseve natyrore, minimizimin e ndikimeve negative mjedisore dhe përfshirjen e komuniteteve lokale në zhvillimin turistik.

Nese këto rekomandime zbatohen me sukses, mund të ndihmojnë në rritjen e sektorit të turizmit në Kosovë, të zhvillojë një industri turistike të qëndrueshme dhe tërheqëse që kontribon në rritjen ekonomike dhe njohjen ndërkombëtare të vendit.

PËRFUNDIM

Si përfundim mund të themi se Kosova edhe pse një vend me sipërfaqe jo shumë të madhe, ajo ka pasur fatin të posedojë mjaftë resurse dhe potenciale turistike, si dhe peisazhe mahënitëse të cilat do të krijojnë përvoja të paharruara për vizitorët qofshin ata vendas apo ndërkombëtar. Në periudhën e pas luftës në Kosovë edhe sektori i turizmit si sektorët e tjerë të ekonomisë kosovare filloj së funksionuari me vështirësi të mëdha për arsye se përveç dëmeve që kishte pësuar nga masat e dhunshme para lufte kishte pësuar dëme të konsiderueshme gjatë luftës, po ashtu në një numër të konsiderueshëm të objekteve turistike ishin vendosur KFOR-i dhe UNMIK-u. E vetmja qendër turistike „Brezovica” ende gjendet jashtë rrjedhave normale zhvillimore të turizmit dhe jashtë mbikëqyrjes institucionale të Kosovës ³⁸. Territori i Kosovës posedon bazë solide natyrore (pasuri dhe potenciale të shumta të nëntokës dhe mbitokës) si dhe resurse humane me strukturë të volitshme dhe të fuqishme për zhvillimin ekonomik³⁹. Kosova ka shanse të mrekullueshme për zhvillim të turizmit. Disponon me atraksionet natyrore të begatshme, me lokacione gjeografike të volitshme. Disa prej përparësive të saj turistike të veçanta janë veçoritë e dallueshme morfologjike, hidro-grafike, klimatike dhe elemente të tjera atraktive të cilat e bëjnë Kosovën një nder hapësirat turistike më tërheqëse në rajon. Edhe pse Kosova nuk posedon disa faktorë, të cilët kanë ndikim tërheqës, në pjesën më të madhe të kërkesës turistike, siç është deti, ajo disponon me potencial të jashtëzakonshëm natyror dhe mundësi tjera për zhvillimin e gati të gjitha formave të turizmit, në radhë të parë, të turizmit dimëror-sportiv, malorë, shëndetësorë, transit, gjuetisë turistike të biznesit etj. Studimet e bëra kanë treguar se në Kosovë ekzistojnë mundësi për ndërtimin e 20 qendrave të turizmit dimëror, të cilat mund të ofrojnë kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportive, sipas standardeve ndërkombëtare⁴⁰.

³⁸ https://pjeterbudi-edu.com/wp-content/uploads/2018/05/Revista_Studentore_nr_1_2009-1.pdf ,2009. Fq.7.

³⁹ Blaku, Rifat “Ekonomia e Resurseve” fq.201. Prishtinë, 2005

⁴⁰ https://pjeterbudi-edu.com/wp-content/uploads/2018/05/Revista_Studentore_nr_1_2009-1.pdf 2009, fq.33

BURIME NGA INTERNETI

https://pjeterbudi-edu.com/wp-content/uploads/2018/05/Revista_Studentore_nr_1_2009-1.pdf ,
Prill 2009, fq.5

https://pjeterbudi-edu.com/wp-content/uploads/2018/05/Revista_Studentore_nr_1_2009-1.pdf ,
2009, fq.34

<https://drejtesia.blogspot.com/2007/08/turizmi-n-kosov.html>

<https://spektri.tv/10-vendet-turistike-qe-duhet-vizituar-ne-kosove/>

<https://www.kas.de/documents/286052/0/19-12-24+Foreign+Direct+Investment+in+Kosovo+-+The+Investment+Climate%2C+Potential+and+Barriers+%28ALB%29.pdf/22d365b2-08dc-27f5-d35b-f2c17e1b184e?version=1.0&t=1580216557431>

<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf> fq.36

<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf> fq.37

<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf> fq.37

<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf> fq.37,38.

<https://rtv21.tv/turizmi-ne-kosove-kapacitetet-dhe-problemet/>

https://pieterbudi-edu.com/wp-content/uploads/2018/05/Revista_Studentore_nr_1_2009-1.pdf,2009 Fq.7

https://pieterbudi-edu.com/wp-content/uploads/2018/05/Revista_Studentore_nr_1_2009-1.pdf 2009, fq.33.

LITERATURA

Blaku, Rifat. 2005. *EKONOMIA E RESURSEVE*. PRISHTINË: PROGRAF.

Blaku, Rifat “Ekonomia e Resurseve” fq.201. Prishtinë, 2005

Doka, Dhimitër, und Bilal Draçi. 2009. *GJEOGRAFIA E TURIZMIT*. TIRANË: ASD-Studio.

Doka, Dhimitër; Draçi, Bilal “ Gjeografia e turizmit” fq.77. Tiranë, 2009

Gashi, Musa. 1986. *BAZAT E TURIZMIT*. Prishtinë: PROGRES- SVETOZAR GJEORGJEVIQ.

Gashi, Musa “ Bazat e turizmit” fq.190. Prishtinë 1986.

HASANI, Fatmire. 2007. *Turizmi në Kosovë*. 24. August

Koja, Vita, und Klodiana Gorica. 2007. *MARKETINGU I TURIZMIT*. albPAPER.

Koja, Vita; Gorica, Klodiana “Marketingu i Turzmit” 2007 fq.113.

Koja, Vita; Gorica, Klodiana “Marketingu i Turzmit” 2007 fq.189.

Kovaçi, Idriz, und Alberta Tahiri. 2022. *TURIZMI I QËNDRUESHËM*. Prishtinë: CIP.

Tahiri, Alberta; Kovaçi, Idriz, “Turizmi i qëndrueshëm “fq.22,23. Prishtinë 2022.

Tahiri, Alberta; Kovaçi, Idriz , “Turizmi i qëndrueshëm” fq.192. Prishtinë 2022.

Kovaçi, Idriz; Tahiri, Alberta “Turizmi i Qëndrueshëm “. Fq. 184. Prishtinë 2022

Reçica, Fetah, und Bedri Millaku. 2011. *EKONOMIA E TURIZMIT*. Prishtinë: CIP.

Millaku, Bedri; Reçica, Fetah “Ekonomia e Turizmit“ Fq.58, Prishtinë,2011.

Reçica, Fetah; Millaku, Bedri “Ekonomia e turizmit“ fq.78. Prishtinë 2011.

Reçica Fetah, Millaku Bedri " Ekonomia e Turizmit“ fq.296. Prishtinë, 2011.

Millaku, Bedri; Reçica, Fetah “Ekonomia e turizmit“ fq.73,74. Prishtinë 2011.

Millaku, Bedri ; Reçica, Fetah “Ekonomia e turizmit“ fq.75,76. Prishtinë 2011.

REÇICA, FETAH, und BEDRI MILLAKU. 2014. *Hyrje në Turizëm*. Prishtinë: OLIMP.

Reçica, Fetah; Millaku, Bedri “Hyrje në Turizëm“ Fq. 270. Prishtinë, 2014

—. 2014. *HYRJE NË TURIZËM*. Prishtinë: OLIMP.

Reçica, Fetah; Millaku, Bedri “Hyrje në Turizëm" Fq. 270. Prishtinë, 2014

Reçica, Fetah; Millaku Bedri “Hyrje në Turizëm “Fq. 12, 13, 14. Prishtinë, 2014.

Reçica, Fetah; Millaku, Bedri “Hyrje në Turizëmm” Fq.265. Prishtinë, 2014.

Reçica, Fetah; Millaku Bedri “Hyrje në Turizëm“ Fq. 273, 274 . Prishtinë.

Selimaj, Afrim, Bedri Millaku, und Adem Dreshaj. 2019. *EKONOMIA E TURIZMIT DHE BIZNESI*. Pejë: DUKAGJINI.

Selimaj, Afrim; Millaku, Bedri; Dreshaj, Adem “Ekonomia e turizmit dhe biznesi“ Fq.46. Viti.2019.

Selimaj, Afrim; Millaku, Bedri; Dreshaj, Adem “Ekonomia e turizmit dhe Biznesi“ Pejë, 2019

Selimaj, Afrim; Millaku , Bedri; Dreshaj, Adem “Ekonomia e turizmit dhe biznesi“ fq.88, 89. Pejë, 2019.

Selimaj, Afrim; Millaku, Bedri; Dreshaj, Adem. “ Ekonomia e turizmit dhe biznesi“ fq.86. Pejë, 2019